



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PERMET

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_\_

**PËR BUXHETIN E BASHKISË VITI 2025 DHE PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË  
PUNONJËSVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE  
ADMINISTRATIVE NE VARËSI TË SAJ**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Per marrëveshjet nderkombetare në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.775 datë 24.09.2010 "Per administrimin e financimeve te huaja" Udhëzimi nr.07.2024 "Per rregjistrimin,përdorimin,rakordimin,raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve të huaja në kuadrin e marreveshjes nderkombëtare", Shkreses nr.14488 date 29.10.2024,dergohet per njoftim transferta e pakushtezuar e përgjithshme dhe sektoriale.per vitin 2025",protokolluar me tonen nr.2869,date 31.10.2024, Këshilli i Bashkise, me propozim të Kryetarit të Bashkise,

**VENDOSI:**

1. Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2025. të jenë 487,849 mije lekë sipas tabelës së planit të të ardhurave viti 2025. bashkëngjitur.
2. Shpenzimet gjithësej të jene 487,849 mije lekë sipas tabelës së planit të shpenzimeve të vitit 2025, bashkëngjitur.
3. Te ardhurat e pritshme nga marrëveshjet ndërkombëtare (projekte) për vitin 2025, te jenë 8 472 mije lekë sipas tabelës se planit të te ardhurave viti 2025,me skeme te plote Thesari bashkëngjitur.
4. Shpenzimet për marrëveshjet nderkombetare (projekte) për vitin 2025,te jene 8 472 mije lekë sipas tabelës së planit të shpenzimeve të vitit 2025,me skeme te plote Thesari bashkëngjitur.
5. Te ardhurat e pritshme nga marrëveshjet ndërkombëtare (projekte) për vitin 2025, te jenë 38,140 mije lekë sipas tabelës se planit të te ardhurave viti 2025,me skeme te pjesshme Thesari bashkëngjitur.
6. Shpenzimet për marrëveshjet nderkombetare (projekte) për vitin 2025,te jene 38,140 mijë lekë sipas tabelës së planit të shpenzimeve të vitit 2025,me skeme te pjesshme Thesari bashkëngjitur
7. Te ardhurat e pritshme nga marrëveshjet me UNDP , (projekte ),për vitin 2025, te jenë 1,537 mije lekë sipas tabelës se planit të te ardhurave viti 2025, bashkëngjitur.

8. Shpenzimet për marrëveshjet me UNDP, (projekte) ,për vitin 2025,te jene 1,537 mijë lekësi pas tabelës së planit të shpenzimeve të vitit 2025, bashkëngjitur.
9. Numri i përglithshërn i punonjesve te Bashkise Permet, institucioneve dhe Njesive Administrative në varësi të saj të jetë 316,si me poshtë:
  - Numri i punonjësve të Bashkise Përmet dhe Njësive Administrative në varësi të jetë 232 punonjes.
  - Numri i punonjësve i institucioneve te transfetuara -varësi te Bashkise jetë 84 punonjes.
10. Numri i punonjësve për projektet me fonde te huaja të jetë 4.
11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISE  
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Përmet, më \_\_\_\_\_ 2024

**P/VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE DHE SHPËRBLIMEVE TË  
PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR TË  
BASHKISË PËRMET DHE TË INSTITUCIONEVE QË VAREN PREJ SAJ, PËR VITIN  
2025**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ , neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” ,pika ç,VKM nr.177 datë 08.03.2017” Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.419 datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në VKM nr.240 datë 20.04.2023 , të Këshillit të Ministrave “Per trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin,të ndryshuar,VKM nr 241 datë 20.04.2023”Per trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të tjerë jomësimore , ne arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, VKM nr 425 date 26.06.2024“Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike ,të ndryshua ,VKM nr 421 datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës së pagave , nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit,funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit ,nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, VKM nr.503 datë 01.08.2024 “Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emeruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore, VKM nr 113 datë 01.03.2023“Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, referuar shkresës nr. prot,14488 datë 29.10.2024 për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,



## VENDOSI:

I. Të miratojë nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të bashkisë e personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi ,si vijon:

1. Kryetar i Bashkisë ..... 240.000 lekë / muaj
2. Nën Kryetar i Bashkisë ..... 185.000 lekë / muaj
3. Sekretar i Përgjithshëm ,Klasa I-5, shtesë/pozicion ..... 170.000 lekë / muaj
4. Drejtor Kabineti, Klasa II-2 Shtesë/pozicion ..... 120.000 lekë / muaj
5. Specialist Audit Klasa IV-3 shtesë /pozicioni ..... 70.000 lekë/muaj
6. Sekretar i Këshillit Bashkiak ,Klasa II-2 Shtesë/pozicion..... 141.000 lekë / muaj
7. Administrator Qyteti ..... 145.000 lekë / muaj
8. Administrator të Njësive Administrative..... 130.000 lekë / muaj
9. Drejtor Drejtorie , Klasa II-2, shtesë pozicioni ..... 120.000-141.000 lekë /muaj
10. Përgjegjës sekt., Klasa III-2 shtesë pozicioni..... 105.000 lekë / muaj
11. Përgj. sektori ,Klasa III-3 shtesë/pozicioni..... 65.000-98.000 lekë / muaj
12. Inspektor i Policisë Bashkiak shtesë /pozicioni ..... 70.000 lekë/ muaj
13. Polic Bashkiak me arsim të lartë shtesë /pozicioni ..... 45.000 lekë/muaj
- 13.1. Polic Bashkiak me arsim të mesëm..... 47.000 lekë/muaj+ 1% vjetërsi
14. Inspektor i mbrojtjes së territorit shtesë /pozicioni ..... 70.000 lekë / muaj
15. Specialist ,inspektor ,bashki, Klasa IV-3 shtesë /pozicioni ..... 42.000-70.000 lekë/muaj
16. Specialist me arsim të lartë, Klasa IV-4 shtesë /pozicioni ..... 40.000-60.000 lekë/ muaj
17. Punonjës me arsim të mesëm të Bashkisë, institucioneve në varësi, ... 40.000-47.000 lekë / muaj.
18. Punonjësit e Njësive Administrative me arsim të lartë do të paguhet me pagë pozicioni - 40.000 lekë / muaj , punonjësit me arsim të mesëm – 40.000 lekë / muaj .
19. Pagat e punonjësve të arsimit dhe punonjësve mbështetës të këtij sektori, sipas VKM nr 425 date 26.06.2024.
20. Pagat e punonjësve të MZSH-së sipas VKM nr.419 datë 26.06.2024 .
21. Pagat e punonjësve të Gjendjes Civile sipas VKM nr 421 datë 26.06.2024 .
22. Shpërblimi për këshilltarët 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
23. Shpërblimi për kryetarët e fshatrave të jetë 5% e pages së Kryetarit të Bashkisë.

II. Për nevoja të titullarit dhe të institucionit të ketë në dispozicion **Këshilltarë të Jashtëm** pa pagesë , të specializuar në fusha të ndryshme .

III. Strukturës së Bashkisë i bashkohet dhe stafi që do të angazhohet në implementimin e tre projekteve AR.CH. ETHICS ,Key People- Key knowledge, RIWET projekte të financuara nga Be-ja .

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

V. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga 01.01.2025 deri në 31.12.2025 .

**KRYETAR I BASHKISË  
ALMA HOXHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ DATE \_\_\_\_\_

**PËR MIRATIMIN E FAZES PERFUNDIMTARE (FAZA E III) E BUXHETIT  
AFATMESEM 2025-2027, BASHKIA PERMET .**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". i ndryshuar, Udhëzimit nr.3, date 28.02.2024, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes vendore, Udhëzimit nr.8, Date 05.07.2024, "Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", "VKB nr.26, date 03.04.2024, "Për miratimin e tavanëve buxhetore për PBA 2025-2027", VKB nr.68, date 25.09.2024, "Për miratimin e projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 Faza e II", Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**VENDOSI:**

- 1-Të miratojë Projekt Buxhetin Afatmesëm për vitet 2025-2027, faza përfundimtare ( faza e III) për Bashkinë Permet.
- 2- Për Zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Buxhet-Financë, Burimet Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- 3-Ky vendim hyn në fuqi 10( dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**  
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

**PROJEKT VENDIM**

NR. \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_\_  
PËR

**MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT  
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026 TË  
BASHKISË PËRMET**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr.68/2017 "Për finanacat e vetqeverisjes vendore", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008" Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ", i ndryshuar, ,Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm " të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshilli Bashkiak,me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kalendarin e përgatitjes së programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bashkisë Përmet ,sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**  
**Alma HOXHA**

**Alma  
Hoxha**

Digitally signed by Alma Hoxha  
Date: 2024.12.13 17:14:51 +0200





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

PËR MIRATIM PRIORITET INVESTIMESH

Këshilli Bashkiak Përmet, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 117.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligj Nr.107dt31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Te miratoje prioritet investimesh per tre vjecarin 2025-2027 objektet si me poshte:

Nr.	Emërtimi i projektit	Lloji i shërbimit	Vlera			
			2024	2025	2026	2027
1	Rikonstruksion "Pallati i Sportit"	Sporti		17,723,589.00		
2	Rehabilitim i Kopshtit Nr.1	Arsim		47,172,000.00		
3	Rehabilitim i stadiumit "Durim Qypi"	Sporti		6,230,843.00		
4	Rikualifikimi urban i "Lagjes së Re"	Shërbim publik			126,000,000.00	
5	Mbrojtjes nga ujërat e lartatë Perroi I Bardhe në qytetin e Përmetit Loti I parë	Bordi I kullimit		96,725,710.00		
6	Rehabilitimi i KUZ Përmet	Ujshjellës				600,000,000.00
7	Kanali ujitës Buhal	Bordi I kullimit		23,854,565.00		
8	Kanali ujitës Rapçkë	Bordi I kullimit			30,000,000.00	
9	Rikonstruksion i rrugës Draqovë - Kanikol	Rruge				30,800,000.00
10	Ndërtimi i rrugës hyrëse fshati Qilarisht	Rruge		41,266,000.00	29,894,000.00	14,440,000.00
11	Rehabilitim i Rezervuarit Qilarisht	Bordi I kullimit		29,150,211.00		
12	Ujshjellësi rajonal faza III ( Rapçkë, Verçisht, Gostomickë, Kanikol, Iliarë, Toranik, Buhal, Qilarisht, Grabovë, Raban, Kosovë, Ogren, Pagri, Frashër, Strëmbec, Kaludh, Pellumbër, Zhenë, Draqovë)	Ujshjellës			250,000,000.00	
13	Ndërtimi i rrugës Buhal - Përmet	Rruge				120,000,000.00
14	Ndërtimi i rrugës hyrëse Pacomit	Rruge			21,471,000.00	28,212,300.00
15	Sistemim – asfaltim i rrugës në lagjen "Nonda Bulka" Përmet	Rruge				25,000,000.00
16	Ndërtimi i urës së varur midis Parkut "Aristidh Kola" dhe "Kupola"	Rruge			35,000,000.00	
17	Rikonstruksion Shkollë 9-Vjecare "Meleq Gosnisti"	Arsim	38000000	78,794,932.00		
18	Sistemim – asfaltim i rrugëve në lagjen "SEDE" Përmet	Rruge				50,000,000.00
19	Shpronësim për interes publik " Vëreza"	Shërbim publik		5,441,000.00		





SEKTORI  
PËR  
BASHKIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

20	Ndërtim i rruges së fshatit Grabovë	Rruge		45,000,000.00		
21	Ndërtimi i urës lidhëse midis "Lagjes Bajame" dhe "Lagjes së Re"	Rruge				55,000,000.00
	<b>Total</b>		<b>38,000,000.00</b>	<b>391,358,850.00</b>	<b>492,365,000.00</b>	<b>923,452,300.00</b>

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefektura.

**KRYETARI BASHKISE  
ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KRYETARI

P/VENDIM

Nr. \_\_\_ datë \_\_\_ / \_\_\_ 2024

**PËR**  
**FINANCIMIN E DISIPLINAVE SPORTIVE SIPAS BUXHETIT 2025 TË BASHKISË**  
**PËRMET PËRMES METODOLOGJISË LOD**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, neni 25 pika 4, i ndryshuar; Ligjit 79/2017 «Për Sportin» neni 21; Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKB Nr.72 datë 17.10.2017 «Për miratimin e Metodologjisë LOD» dhe Memrandumin e Mirëkuptimit Nr.2608 Prot datë 23.09.2021 në kuadër të programit Reload 2; Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë financimin e disiplinave sportive sipas Buxhetit të Bashkisë Permet për vitin 2025 përmes Metodologjisë LOD.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Sporteve, Drejtoria e Projekteve dhe Drejtoria e Buxhet Financë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**  
**ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ dt \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2024

PËR

MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MESATARE TË APARTAMENTEVE NË  
TREGUN E LIRË PER VITIN 2025 NË BASHKINË PËRMET.

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2024, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", pika 2/b dhe pika 10, Vendim Nr.301, Datë 15.4.2020 "Për Normat e Strehimit si dhe Kushtet e Standardet për banesat Sociale me Qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar Strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore" pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni konsultativ i strehimit dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Të miratojë qiranë mesatare të apartamenteve në treg për vitin 2025 në Bashkinë Përmet si më poshtë:

Për apartamente të tipit Garzionere : 4 000 lek.

Për apartamente të tipit 1+1 : 5 000 lek.

Për apartamente të tipit 2+1 : 7 000 lek.

- 1- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit, Drejtorja e Financë-Buxhetit-Taksa Tregje,Zyra e Aseteve dhe Shërbimeve Publike në Bashki.

- 2- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË  
ALMA HOXHA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ dt \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË NË TREGUN E LIRË PËR DHËNIE  
APARTAMENTË PËR FAMILJET E PASTREHA ME STATUS TË MIRATUAR**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.22/2018" Për strehimin social" i ndryshuar, Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar Strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore", VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", pika 2/b dhe pika 10, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Komisioni konsultativ i Strehimit dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë.

**VENDOSI:**

- 1- Të miratojë listën e përfitueseve dhe vlerës së subvecionimit të qerasë për familjet të pastreha me status që përfitojnë bonus qiraje nga fondi i dhënë nga Bashkia për vitin 2025 sipas **Aneksi 1 bashkëlidhur** dhe është pjese përbërëse e këtij vendimi.
- 2- Familja që ka përfituar subvecionimin e qerasë mund të dalë nga kjo skemë pas nje viti në rast se vërtetohet që ajo e ka zgjidhur problemin e strehimit, ose nëse të ardhurat e familjes janë rritur mjaftueshëm për të përballuar pagesën e qerasë pa nevojën e bonusit dhe skualifikohen sipas metodikës së përlogaritjes së qerases.
- 3- Familja që ka përfituar subvecionimin e qerasë duhet të beje deklarinimin pranë Bashkisë në rast se u ndryshojne kushtet e strehimit apo kushtet ekonomike. Familjet kanë detyrimin që brenda 10 diteve të para të muajit të gjashtë nga momenti i fillimit te subvecionimit të bonusit të qerases duhet të beje përditesimin e informacionit rreth ndryshimeve të familjes për kushtet e strehimit ose kushtet ekonomike me dokumentat përkates, ne të kundërt familja skualifikohet nga pagesa e subvecionimit të qerasë.
- 4- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet komisioni konsultativ i strehimit, Zyra e Strehimit, dhe Drejtoria e Finances dhe Buxhetit.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**

ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/ VENDIM

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT  
PËR VITIN 2025.**

Këshilli Bashkik Përmet mbledhur më dt. \_\_\_/\_\_\_/2024 mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, pika 12 gërma "a" e V.K.M. Nr.384 dt. 12.06.2019, pika 12/a "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit" Vendimit Nr.301, Datë 15.4.2020 "Për Normat e Strehimit, si dhe Kushtet e Standardet për Banesat Sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", VKM Nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", VKM Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", VKM Nr.459, datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKM Nr. 361, datë 29.5.2019 "Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional", VKM Nr. 362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" Pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga njesia e strehimit dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë

**VENDOSI:**

- 1-Të miratojë sistemin e pikëzimit për programet sociale të strehimit për vitin 2025 si më poshtë.
  - a- Të miratojë sistemin e pikëzimit për programin e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2025 sipas tabelës **Aneksi 1**, bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij.
  - b- Të miratojë sistemin e pikëzimit për vlerësimin e familjeve aplikuese sipas programit "Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese" në zbatim të nenit 16, të ligjit nr 20/2020 për vitin 2025 sipas tabelës **Aneksi 2**, bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij.
  - c- Të miratojë sistemin e pikëzimit për subvencionimin e interesave të kredisë nga shteti për vitin 2025 sipas tabelës **Aneksi 3**, bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit, Zyra e Strehimit dhe e Shërbimeve Publike,

Zyra e Finance-Buxhetit në Bashki.

3-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**  
Alma HOXHA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_, 2024

**PËR DHËNIE BURSA DHE PAGESA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME  
PROFESIONALE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025.**

Mbështetur edhe në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.666 datë 10.10.2019" Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2024-2025" si dhe në bazë të planit të shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë dhe në vazhdim për nxënësit që kanë përfituar bursë në vitin paraardhës në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2024-2025 dërguar me Shkresën e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me nr.13089/1 Prot, datë 23.10.2024, me propozim të sektorit Juridik, B.NJ dhe Arsimit

**VENDOSI:**

- 1. Të miratojë dhënien e bursave të plota për nxënësit e vitit të parë për shkollat e Arsimit të Mesëm Profesional sipas pikës 2.1 (a dhe b) të VKM Nr. 666 datë 10.10.2019 dhe atyre që kanë përfituar në vitet paraardhëse si më poshtë:**

**1.1 Fjoralb Florenc Kapllani i datëlindjes 29.05.2009**

Nxënës në klasën e dhjetë sistemi 4 –vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale Teknike "Demir Progri" Korçë, dega Elektroteknikë.

- 2. Të rikonfirmojë bursat për nxënësit e vitit të dytë e në vazhdim për shkollat e Arsimit të Mesëm Profesional**

**2.1 Neritan Aldmir Jaupaj i datëlindjes 07.04.2008**





Nxënës në klasën e njëmbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë, Dega Termohidraulik

**2.2 Grigor Arben Filja i datëlindjes 08.08.2007**

Nxënës në klasën e njëmbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë, Dega SHMT ( Shërbime Mjetesh Transporti).

**2.3 Renato Alban Rakipi i datëlindjes 15.05.2007**

Nxënës në klasën e njëmbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë, Dega SHMT ( Shërbime Mjetesh Transporti

**2.4 Joan Artur Kristo i datëlindjes 26.12.2006**

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë, Dega TIK( Teknologji informacioni dhe komunikimi).

**2.5 Eldjon Ardian Ibrahim i datëlindjes 17.09.2006**

Nxënës në klasën dymbëdhjetë e sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale " Beqir Çela" Durrës, dega Mekanikë

**2.6 Gerald Erion Alizoti i datëlindjes 26.08.2006**

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale " Beqir Çela" Durrës, dega Teknologji Informimi Komunikimi ( TIK)

**2.7 Sara Agron Toska e datëlindjes 05.04.2006**

Nxënëse në klasën e trembëdhjetë sistemi 4-vjeçar, në Shkollën e Mesme Artistike ( profesionale) "Feim Ibrahim" Gjirokastrë, dega pikturë

**2.8 Alkeos Fredi Lame i datëlindjes 26.03.2006**

Nxënës në klasën e trembëdhjetë sistemi 4-vjeçar, në Shkollën e Mesme Artistike ( profesionale) "Feim Ibrahim" Gjirokastrë, dega pikturë.

**3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Zyra Juridike dhe Sektori i Financë- Buxhetit të Bashkisë Përmet.**

**4. Vendimi hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.**

**KRYETARI BASHKISE  
Alma HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, Date \_\_\_\_\_, 2024

PER

**DHENIE PAGESA KUOTA USHQIMORE PER NXENESIT E ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR PUBLIK PER VITIN SHKOLLOR 2023-2024, TË CILËT JANË  
VENDOSUR NË KONVIKTIN E QYTETIT**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore", Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.666 date 10.10.2019 me disa ndryshime ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.511 date 27.07.2022 "Per kuotat financiare të ushqimit ne mensa e konvikte dhe percaktimin e kriterëve per perfitimin e bursave e te pagesave për nxenesit e arsimit parauniversitar ne intitucionet arsimore publike per vitin shkollor 2024-2025" si dhe ne baze te planit te shperndarjes se bursave per vitin mesimor 2024-2025 derguar me shkresen nr.449 Prot., date 14.01.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

**VENDOSI:**

**1. Te miratoje përfituesit e kuotës së plotë ushqimore për nxënësit e arsimit parauniversitar të Gjinnazit publik "Sami Frashëri", Përmet të cilët janë vendosur në Konviktin e Qytetit si më poshtë:**

**1.1 Kristo Koço Petuqi**

Nxenes ne klasen e dymbedhete të Gjinnazit "Sami Frashëri", Permet, banuese ne Fshatin Draçovë, Njësia Administrative Çarshovë, Bashkia Përmet

**1.2 Parios Ligor Proko**

Nxenes ne klasen e dymbedhete të Gjinnazit "Sami Frashëri", Permet, banuese ne Fshatin Kaludh, Njësia Administrative Petran, Bashkia Përmet

**1.3 Yllka Astrit Mera**



Nxënëse në klasën e dymbëdhjete të gjimnazit "Sami Frashëri" Përmet, banues në Përmet, Bashkia Përmet

3. Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Zyra Juridike dhe Sektori i Finance- Buxhetit prane Bashkise Permet.

4. Vendimi hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISE

Alma HOXHA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P./VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_, 2024

Për

**“Përrjashtimin nga tarifa e kopshtit dhe çerdhes me drekë për familjet me shumë fëmijë, familjet e komunitetit rom dhe egjiptjan, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, fëmijet që kanë statusin e jetimit, fëmijet me një prind, familjet që kanë binjak përrjashtohet njëri”.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeversijen vendore”,neni 54”detyrat dhe kopetencat e Keshillit Bashkiak” i ndryshuar, Ligji 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi i KB Nr.68 datë 25.09.2024 “Për miratimin e Buxhetit afatmesëm të Bashkisë Përmet viti 2025-2027”,Ligji nr.10221 datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë përrjashtimin nga tarifa e kopshtit dhe çerdhes me drekë për familjet me shumë fëmijë, familjet e komunitetit rom dhe egjiptjan, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, fëmijet që kanë statusin e jetimit, fëmijet me një prind, familjet që kanë binjak përrjashtohet njëri”.

2. Eftektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga data 01.01.2025-31.12.2026.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISË

Alma HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

## P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR**  
**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIDHUR ME VKM-NË NR. 329, DATË 22.5.2019, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE, PËR EFEKT REGJISTRIMI" DHE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT PËR 13 (TREMBËDHJETË) FAMILJE.**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Vkm nr.329, datë 22.5.2019, "për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjencinë shtetërore të kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi".

Këshilli i Bashkisë Përmet, në mbledhjen e datës \_\_\_/\_\_\_/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

### VENDOSI:

1- Të përfundohen procedurat për lidhjen e kontratës së shitjes së truallit të noteri lidhur me VKM 329 datë 22.05.2019 për 13 (trembëdhjetë) familje si më poshtë :

- 1 Shkëlqim Maksuti
- 2 Dhimitraq Mitrushi
- 3 Shpëtim Sadiku
- 4 Kastriot Nauni
- 5 Petraç Nauni
- 6 Vasil Bidika
- 7 Halim Selfo



- 8 Selim Beqaraj
- 9 Andriatik Anxhaku
- 10 Edmond Topoviti
- 11 Mihal Fisheku
- 12 Stavro Fisheku
- 13 Mikail Lile ,

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës/Planifikimit të Territorit/Sektorit Juridik.

3. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**KRYETAR I BASHKISË**

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_, 2024

**P/VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI  
DHJETOR 2024**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqerore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike", VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.97 datë 18.12.2023 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihme ekonomike për Muajin DHJETOR 2024, 31 familje me një fond 76.278 lekë.

2. Fondet të përballohen nga struktura :

**1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.01.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 76.278 leke**

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	2400
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	2700
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	3000
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	2600
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	2100
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3000
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3000
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	1800
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	3000
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	1800
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	2400
12	Vera Thanas Naqe	E ve	2	2100
13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	2100



14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	3000
15	Xhensila Maksim Jahaj	Beqare me Femijë	2	2600
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	1800
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3000
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	3000
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	1800
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	2600
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	2400
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	1800
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	2100
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	3000
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	1800
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	3000
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	2178
28	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	3000
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	2100
30	Almir Muharem Malkë	Yllka Pasho Malkë	5	2100
31	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	3000
	<b>SHUMA</b>			<b>76.278</b>

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**  
**Alma HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

P/VENDEM

**Per miratimin e fondit te kushtezuar per bllok ndihmes ekonomike, deri ne 6% .**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqërore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 te K.M."Per percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditësuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.97 date 18.12.2023 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj". Keshilli Bashkiak,me propozim te Kryetares se Bashkise:

**VENDOSI**

1.Te perfitojne ndihme ekonomike per Muajn Nëntor 2024, 9 familje me nje fond prej 28.807 leke

2. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraç Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	2.178
4	Klodjana Kristofor Peci	Divoreuar	1	2.178
5	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
6	Mimoza Skender Gjoka	Divoreuar	1	2.178
7	Lefteri Mihal Tyto	Divoreuar	1	5.720
8	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
9	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	2	3.267
	<b>SHUMA</b>			<b>28.807</b>

3..Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

**KRYETAR I BASHKISE SHQIPËRIË**  
**Alma HOXHIA**  
  






**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT - V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE DHE BUXHETIT TË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËRMET PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2025**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 gërma b, nenit 51 pika 3, neni 54 gërma k, nenit 55 pika 2 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në zbatim të Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Përmet, Këshilli i Bashkisë Përmet, në mbledhjen e dates 18.12.2024, pas propozimit të Kryetarit të Këshillit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Aktiviteteve dhe Buxhetit të Këshillit Bashkiak Përmet për periudhën Janar – Dhjetor 2024, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

**K R Y E T A R I K Ë S H I L L I T**

Anila DHIMITRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

## PROJEKT VENDIM

NR. \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_\_  
PËR

### SHUARJEN E DETYRIMIT TË PRAPAMBETUR TË KONTABILIZUAR GABIMISHT QË PREJ VITIT 2016 PËR PROJEKTIM TË OBJEKTIT «RIKUALIFIKIM URBAN I QËNDRËS SË QYTETIT , PËRMET»

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore” dhe Udhëzimin nr.35 datë 29.12.2023 “ Procedura për manaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

#### VENDOSI:

- 1.Të shuajë detyrimin e prapambetur të kontabilizuar në vlerën 2 200 102 lekë në llogarinë 4864400 me palë kreditore TEC CONSULT për Projektim i objektit “Rikualifikim urban i qendrës së qytetit ,Përmet”.
2. Ngarkohet administra e Bashkisë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij akti.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË  
ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PËR**

**MIRATIMIN E NUMRIT, NIVELIT TË SHPËRBLIMEVE DHE ORËVE TË PUNËS TË INSTRUKTOREVE TË JASHTËM TË KONTRAKTUAR NGA BASHKIA PËRMET PËR VITIN 2025**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024, mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 “Detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak” i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, VKM nr.511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, Udhëzimin Nr.21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore- edukative dhe numrit të nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit parauniversitar” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**VENDOSI:**

1. Numri i instruktorëve të jashtëm të kontraktuar nga Bashkia Përmet për vitin 2025 të jetë deri në 6 instruktorë, të cilët do punojnë me fëmijët në sektoret:
  - a) Artistik dhe sportiv
  - b) Shkencor
2. Paguesa e shpërblimeve të Instruktorëve të jashtëm për vitin 2025 do të bëhet deri në 24 orë punë në muaj.
3. Llogaritja e pagesës për instruktorët do të jetë e njëvlefshme me pagën mësimore për një orë punë mësimore , në bazë të ligjeve dhe vendimeve në fuqi.
4. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga 01.01.2025-31.12.2025
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË  
Alma HOXH

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË